



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60//03-7800/22
Kaçanik, 24.03.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III-të (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 mars 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF, ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri, Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, dhe Rabije Sallahi. Në mbledhje mungoj me arsy, Ardita Rrahmani

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtive: Qamil Stagova-drejtor i DUKMM, Ramadush Osmani-drejtor i DSHPE dhe Bahri Selimi- drejtor i DBF, ndërkaq nga zyrtarët, Arbnora Kuka-Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimi i Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, kërkoi mirëkuptim për pikat e rendit të ditës që kanë ardhur me vonesë, megjithatë janë kompletuar si materiale, megjithatë jemi në kohën e duhur me i përcjellë për KK, kur dihet se edhe nga KPF mund të nxjerrën pikë për ti proceduar në KK. Në vazhdim konstatoj kuorumin, kushte pune për tu mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data 24 mars, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës;
3. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve;
4. Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik;
5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të paspenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022;
6. Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
7. Raporti i punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut;
8. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për vitin 2022;
9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2;
10. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0;
11. Propozim Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë;

12. Propozim Vendim për emërimin e anëtarëve te komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Përpos pikëve sipas ftesës për mbledhje, u propozua pika e 13. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me rendin e propozuar të punës, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Lidhur me rendin e punës, fillimisht ftesa na ka ardhur për 17 pikë, më vonë për 12 pikë, ndërkaq tani përsëri ndryshon rendi i punës me shtimin edhe të pikës me numër 13.

z.Agim Mani: Sa i përket rendit të punës është përzier, së pari na është dërguar rendi i punës me 17 pikë, më vonë me 12 pikë, tani është shtuar edhe 1 pikë për të cilën materiali ka ardhur dje. Unë për pikën e 13 nuk jam i pajtimit me u diskutuar sot, për shkak së na ka ardhur me vonesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika 13. -Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0, materiali iu ka ardhur me vonesë, mirëpo KPF mund të procedojë pikë për KK. Me mirëkuptimin e juaj e shqyrtojmë edhe këtë pikë, nëse jo e lëmë për mbledhjen vijuese, për faktin se materiali ka ardhur me vonesë.

z.Agim Mani: Ne do të kishim mirëkuptim nëse kjo ndodhë njëherë, por çështja është se po përsëriten në vazhdimësi. Edhe materiali për pikët tjera na ka ardhur me vonesë. Pika 13 unë nuk jam i pajtimit me u diskutuar sot, për shkak së materiali na ka ardhur me vonesë.

z. Qamil Stagova: Ka edhe shumë lëndë tjera të kësaj natyre. Qëllimi ka qenë për ti proceduar në këtë mbledhje disa prej tyre. Për mua nuk prish punë, nëse vendosni me hequr pikën e 13, e heqim e lëmë për mbledhjen vijuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo bëhet me mirëkuptimin e të gjithëve, sepse materiali ka ardhur jashtë afatit të përcaktuar. Nëse kemi mirëkuptim, atëherë procedojmë me pikën e 13, nëse jo, e lëmë për mbledhjen vijuese.

znj. Rabije Sallahi: Pasi kemi kohë deri në mbledhje të KK, unë jam e mendimit që kjo pikë të debatohet në këtë mbledhje.

znj. Fitore Vishi: Unë jam e pajtimit që pika e 13-të me u shqyrtuar në këtë mbledhje.

z. Sabedin Vishi: Vërejtja e juaj është me vend, se ka pasur shumë lëndë dhe nuk kanë mundur me u regjistruar me kohë të gjitha, kështu që pikën e 13 më mirë me lënë për mbledhjen vijuese të KPF.

Kryesuesi i Kuvendit: Vërejtjet janë me vend dhe duhet të përcillet si mesazh ekzekutivit që materiali te vijnë me kohë. Atëherë rendin e punës pa pikën 13 e shtroj në votim për aprovim, dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 12 pikëve, me renditjen nga 1-12.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, a ka kush ndonjë vërejtje në procesverbal?: Meqenëse nuk ka kush ndonjë vërejtje, atëherë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së II-të (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 23.02.2022 / Lënda: 01Nr. 60//01-4548/22.

U kalua në shqyrtimin e pikave tjera sipas rendit të punës;

2. Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë në mbledhje, Në këtë Propozim Rregullore procedurat janë zhvilluar, është mbajt edhe dëgjimi publik me qytetarë ashtu siç e parashohin rregullat. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: A është bërë ndonjë testim i alarmit, që me u lëshuar alarmi nga sektori i emergjencave, për me shikuar stafi dhe me kuptuar se duhet me dalë jashtë në rast rreziku ?

z. Ramadush Osmani: Jo nuk është bërë testimi. Kjo rregullore i përcakton detyrat e secilit zyrtar të sektorit të emergjencave. Sektori i emergjencave planifikon të mbaj ndonjë lloj trajnimi apo një lloj praktike. E kemi me plan të bëjmë një lloj trajnimi për inskenimin, ku secili do të ketë përgjegjësitë e veta për secilin kat. Drafti ka qenë në diskutim publik me qytetarët dhe grupet e interesit. Objekti i komunës është i kategorisë së 4, siç përcaktohet me ligj, të cilat objekte kërkijnë me pasur një person përgjegjës për mbrojtje nga zjarri, pastaj ai person e merr të gjithë rolin edhe në raste të ndodhjes së ndonjë rasti. Me miratimin e rregullores përcaktohet qartë roli i personit përgjegjës, evidentohen nevojat, qoftë për boca me plin sistemin e alarmimit nga zjarrit, shkallët emergjente etj. Në Rregullore janë përfshirë masat dhe veprimet që duhet ndërmerren për pengim, lokalizim dhe shuarje të zjarrit, me qëllim të shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale.

z. Agim Mani: A posedon komuna mjete - pajisje teknike për mbrojtje nga zjarri, a mirëmbahen ato pajisje nga ndonjë kompani ? Mirë që është proceduar kjo rregullore dhe e njëjtë duhet zbatohet. Me e lehtë është mirëmbajtja sesa me blerë pajisjet të reja, se është me pak e kushtueshme. A është stafi i komunës i trajnuar përfshirë fikje të zjarrit ? Duhet me qenë të trajnuar zyrtarët, sepse pajisje ka pasur, por nuk kanë ditur me i përdorur.

z. Ramadush Osmani: Komuna posedon mjete për mbrojtje nga zjarri, por ato duhet të ndërrohen çdo 6 muaj. Objekti i administratës komunale në vazhdimësi testohet nga sektori i emergjencave. Pajisje ka mjaft, tani testohen dhe ndërrohen, pavarësisht a janë përdorur apo jo. Tani është bërë kërkesa nga DAP përfshirë tu ndërruar. Secila drejtori i ka përgjegjësitë e veta, pajisjet në vazhdimësi testohen nga sektori i emergjencave. Ato e kanë afatin e caktuar dhe nuk ka nevojë përfshirë kompani përmirëmbajtja e tyre. Rregullorja e ka përcaktuar aspektin teknik, dhe përgjegjësit për secilin kat, pastaj vjen aspekti tjetër me i trajnuar, agjenda hartohet nga personi përgjegjës. Shkallë emergjente nuk kemi. Rregullorja krijon bazë ligjore që përcakton përgjegjësitë për secilin person përfshirë të kategorisë së objektit. Objekti i komunës është i kategorisë 4 përfshirë shkak të rëndësisë së që ka objekti. Sektori i emergjencave vendos së kur trajnohen personat përgjegjës.

Kryesuesi i Kuvendit: Pa pasur aparate përfshirë fikjen e zjarreve dhe staf të trajnuar, nuk kanë të drejtë së funksionuar as komuna e asnjë veprimit tjetër. Sektori privat është i obliguar me pasur kompani, ka sektor të veçantë të trajnuar përfshirë testimin e pajisjeve për mbrojtje nga zjarri, ato çdo 6 muaj servisohen, dhe ato që nuk janë të rregullta, ndërrohen. Komuna është institucion publik, ka njësi të zjarrfikësve përfshirë mbikëqyrjen dhe testimin pajisjeve për mbrojtje nga zjarri, e cila njësi e ka në përgjegjësi me i kontrolluar objektet komunale.

Sabedin Vishi: Komuna ka njësi të veçantë të zjarrfikësve, të cilët janë të trajnuar përfshirë fikjen e pajisjeve kundër zjarrit, është stafi i veçantë që merren me këto punë. Nuk është e vërtetë që thuhet se stafi i njësisë nuk kanë ditur me i përdorur pajisjet për mbrojtje nga zjarri.

z. Kadrije Lika-Troni: Unë e shoh të arsyeshme me pasur trajnime të rregullta për përdorim të pajisjeve kundër zjarrit, që stafi të dijë se si me i përdorur pajisjet, sepse nëse dinë me i përdorur pajisjet kundër zjarrit, shpëton jetë. Çka nëse përhapet zjarr në objektin e komunës, i ke pajisjet, por nuk dinë me i përdorur ?

z. Ramadush Osmani: Sektori për emergjencat e ka për detyrë dhe evidenton aparatet, dhe e njofton drejtoren për gjendjen e tyre, skadimin e afateve dhe vendosjen e aparateve të reja. Tani është bërë kërkesa në DAP për pajisjen e aparatet e reja.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka , atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Rregulloren dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, e

APROVON

Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve;

Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi pasur një rregullore 2013, ku janë të përcaktuara tarifat për nisje të kompanive nga stacionit i autobusëve, për krijimin e të hyrave për mbulimin e shpenzimeve të ndërmarrjes komunale të stacionit të autobusëve. Drejtori është këtu, drafti sigurisht se ka qenë në debat publik me qytetarë. Unë kisha dashur mos të ndryshon në këtë kohë ky nen, për shkak se pandemia i ka goditur bukur shumë bizneset dhe në anën tjetër tregu i naftës i ka goditur këto kompani. Fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

z. Ramadush Osmani: Kjo Propozim Rregullore nuk i prek tarifat. Arsyeva pse kemi kërkuar me u ndryshuar, është se krijohet një duplikim i përgjegjësive. Ndërmarrja është aksionare me komunën, me rregullore është përcaktuar caktimi i tarifave. Me statut të ndërmarrjes, te përgjegjësitë e bordit, jepet qartë, e drejta e bordit me i aprovuar tarifat. Edhe në rregullore është thënë në nenin e fundit, nëse rregullorja bien ndesh me ligjin për transport dhe ligjin e ndërmarrjes, dominon statuti edhe ligji. Tarifat nuk mund të ndryshohen pa u ndryshuar kjo rregullore, kështu që çmimet variojnë në trend vazhdimit të që çdo muaj dhe nuk mundem me i aprovuar tarifat varësisht prej çmimeve, se çdo herë duhet me ndryshuar rregulloren. Ne e kemi një rregullore për taksa komunale dhe aty munden me u përfshirë tarifat. Arsyeva pse e kam sjell këtë draft, është në bazë të statutit bordi i miraton tarifat me miratim të komisionit të aksionarëve, me çka nuk mund të aprovojnë tarifa si donë vet, në të njëjtën kohë nuk i pengon rregullorja kur ka nevojë me i ndryshuar tarifat për ulje apo ngritje e tyre. Në këtë kohë nuk ngritën as nuk ulen tarifat, ka me vlerësuar ndërmarrja, bordi kur e sheh të arsyeshme që këto tarifa duhet me u ndryshuar, por me miratim të komisionit të aksionarëve. Ne kemi pasur një kërkësë nga bordi për ngritje të tarifave, adresuar drejtorit të DSHM dhe komisionit të aksionarëve. Çështja është; ose me u miratuar atë kërkësë me u ndryshuar tarifat e propozuara, apo që KK për mos me u marrë çdo vit me ndryshime të tarifave, kjo kompetencë i bartet një organi- komisionit të aksionarëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Bordi ka kërkuar me i ngritur tarifat, ndërkq ne po ua japim të drejtën atyre me i ngritur tarifat me këtë rregullore sa donë vet. Për mua ai bord duhet me hartuar dhe zhvilluar politika të cilat duhet me iu kriuar të hyra në ndonjë formë tjetër e jo duke i goditur transportuesit publik, kur dihet se stacioni i autobusëve ka hapësira të mjaftueshme me zhvilluar biznese, si; dhënien e objekteve me qira, me ndërtuar objekte të reja për me kriuar të hyra, sepse

transportuesit publik janë të goditur nga pandemia dhe tani nga tregu i naftës. Unë jam në kontakt me ta, besoj së këto çështje i kanë paraqitur edhe në debat publik.

z. Ramadush Osmani: Bordi i kompanisë kanë mundur me i ngritur tarifat me përgjegjësitë që ua ka dhënë statuti. Statuti i ndërmarrjes të përgjegjësitë e ndërmarrjes thekson: Bordi ka të drejtë të aprovoj propozime për tarifa dhe të shqyrtoj aplikacione nga kryeshef i ekzekutiv për dorëzim paraprak organit për miratim. Kjo rregullorja thotë: Në rast të konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me ligjin e transportit rrugor dhe statutin e ndërmarrjes, mbizotërojnë dispozitat e ligjit dhe statutit. Ata kanë mundur me u thirrur në këto dispozita e me i ngritur tarifat. Për këtë arsyen kam thënë me ndryshuar komplet rregulloren, me i caktuar tarifat tjera. Arsyet i kam potencuar në arsyetim, se tarifat për një i miraton bordi me miratim të organit të komunës- komisionit të aksionarëve. Ne si komision i aksionarëve nuk ia aprovojmë tarifat, por fillimi i thirrëm akterët e interesit, e vlerësojmë tregun.

z. Agim Mani: A ka pasur iniciativë për ngritje të tarifave ? Cila është tarifa e propozuar ? Në njëfarë forme komisioni i aksionarëve nuk mundet me marrë vendim, por po ia trason rrugën bordit. Bordi merr vendim për ngritjen e tarifave, ndërkaq neve na raportohet për punën e bordit. Çka nëse bordi vendosë me i ngritur tarifat ?

z. Ramadush Osmani: Bordi i kompanisë e ka adresuar një kërkesë organeve kompetente. Ne nuk mundemi me ia miratuar atë kërkesë se na ndal rregullorja. Kërkesa e tyre është shqyrtuar në debat publik me personat të cilët atakohen. Bordi nuk mundet me i ulur apo ngritur tarifat pa e ndryshuar këtë nen, ose atë kërkesë me sjellë bordi në KK për miratimin e tarifave të reja. Ky nen nuk i ngrit as nuk i ulë tarifat, por lënë të drejtën organeve që janë kompetente, por jo vendimmarrës.

Kryesuesi i Kuvendit: Me mirë do ishte me pas ardhur kërkesa e tyre, për me ditur sesa donë me i ngritur tarifat, sesa me ua dhënë të drejtën me i ngritur ata sa donë vet tarifat. Për këtë kohë jam i mendimit mos me u prekur tarifat. Komisioni i aksionarëve ka me na raportuar në KK se bordi i ka ngritur tarifat. Çka nëse bordi merr vendim me i ngritur tarifat? Unë atë bord e kisha shkarkuar menjëherë, se stacioni i autobusëve mundet me krijuar dhe të hyra tjera.

z. Ramadush Osmani: Në mbledhjen e kaluar të KK është formuar komisioni i aksionarëve me 2 anëtarë të KK dhe 1 anëtarë të ekzekutivit. Ai komision ka me sjellë nesër një raport kur t'i vjen ndonjë propozim për ngritje të tarifave nga bordi. Komisioni i aksionarëve thirret në këtë nen të propozuar dhe nuk ia miraton tarifat e propozuara bordit. Kompania është me të hyrat e veta, dhe nëse nuk arrijnë të mbijetoj është në përgjegjësi të komunës, sepse është aksionare me 100%.

znj. Kadrije Lika-Troni: Me intereson të di, kush janë anëtarët e bordit të ndërmarrjes dhe kush është kryeshef i bordit ? Tjetër, Reklama të stacioni i autobusëve, duhet me investuar me u rregulluar, se nuk shihet mirë.

z. Ramadush Osmani: Bordi e mbikëqyrën punën e kompanisë dhe i zbaton politikat e komunës, ndërkaq zbatimin e politikave dhe planin e biznesit e bënë kryeshef i ekzekutiv. Kryeshef i bordit është Naim Baftiu, janë edhe tre punëtorë tjerë. E vetmja formë me gjeneruar të hyra është peroni i autobusëve dhe kombinuesve, eventualisht edhe qiraja e ndonjë autobusi që parkohet aty për ndonjë muaj. Pagën që e merr bordi, është nën 165€, 95 i merr kryesuesi i bordit. Pagën e tyre e cakton komisioni i aksionarëve, ndërkaq shpesh edhe dënohen nga ATK se nuk munden me i bërë pagesat me kohë.

znj. Rabije Sallahi: Pse me u ngritur çmimet e buletave, kur nuk ngritën tarifat, kur dihet së në këtë rast po dëmtohen qytetarët ?

z. Ramadush Osmani: Çmimet e buletave ngriten, sepse tregu është i lirë.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ne i atakojmë këto 3 apo 4 biznese që veprojnë në komunën tonë, përmes tyre po e atakojmë shtresën e varfër.

z. Ramadush Osmani: Bordi ka propozuar tarifa, tarifat nuk miratohen me automatizëm, ndryshimi i tyre nuk mundet me u bërë pa miratimin e komisionit të aksionarëve, se krijohet baza ligjore e cila na jep mundësinë me vepruar në këtë formë.

z. Agim Mani: Linjat ndër- urbane unë nuk besoj se transportuesit e këtyre linjave kanë nevojë me hyrë në stacion të autobusëve.

z. Ramadush Osmani: Linja ndër-urbane, peroni është më shtrenjtë se ka udhëtarë me tepër, si linja Kaçanik- Ferizaj, linjat urbane-periferike janë linjat: Kaçanik- Glloboçicë, Kaçanik- Dubravë etj. këto janë të përcaktuara ne rregulloren për transport të komunës së Kaçanikut.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të linjat e autobusëve Kaçanik- Kovaçec, a janë të rregulluara oraret e transportuesve me orarin e nxënësve, sepse mospërshtatja e orarit të tyre, ndikon tek nxënësit me lodhjen e tyre dhe humbje kohe. Kërkoi që oraret e linjave të transportuesve të rregullohen me oraret e nxënësve.

z. Ramadush Osmani: Me rregullore është i caktuar rendi i udhëtimeve. Rendi i udhëtimit e ka një kohë mbrojtëse. Operatori tjetër nuk guxon me iu ndërrhyrë në atë qarkullim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Rregulloren dhe e njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, e

APROVON

Propozim Rregulloren për ndryshim plotësimin e rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Deri me tani, parkingjet janë menaxhuar nga SHIL. Ka qenë kërkesë e mëhershme që komuna t'i merr në menaxhim parkingjet për krijimin e të hyrave. Tani statusit i invalidëve është i rregulluar me ligj, ata gjëzojnë të drejtat e tyre. Me intereson të di, me financat e ndërmarrjen ‘Pastërtia’, a menaxhon regjioni apo menaxhojmë vet, përndryshe ne mundmi më formuar njësinë tonë.

z. Ramadush Osmani: Sqaroj për komunat që i ka kompania ‘Pastërtia’ në menaxhim, ndërkaq shtoj së iu lejohet komunave me bërë decentralizim financiar, që si ndërmarrje është me aksione të komunës, ndërkaq financat që i krijon njësia operative, nuk i menaxhon më qendra, për shkak të operimit të dobët të menaxhimit, kështu që është marrë vendimi nga bordi, me propozimin tonë, që kryeshefi ekzekutiv me hapë një llogari për të hyrat dhe shpenzimet me u operuar nga njësia Kaçanik. E përbashkët, ka mbetur bordi dhe procedura e prokurimit dhe ajo e rekrutimit. Ata e gjenerojnë listën e pagave, i qesin mjetet, kontributet i bënë ZKF, pagesën e mbeturinave e paguan vet kompania që mban mbeturina, çka të prishet e paguajnë.

z. Agim Mani: Kompania “Pastërtia” duhet me shpreh vullnetin për menaxhimin e krejt mbeturinave.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që e merr në menaxhim kompania, duhet me e kryer punën e vet e mos me i lënë anash mbeturinat. Kur të arrihet marrëveshja, përpos që krijohen të hyra për kompaninë, kompania është mirë të precizohen qartë gjërat, kompania duhet me gjeneruar vende të reja pune në rast së e merr parkingun.

z. Ramadush Osmani: Leja është edhe me gjeneruar vende pune, por ne nuk mundem me ia imponuar kompanisë sa vende, së është çështje e planit biznesor të kompanisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Duhet me ia precizuar, se ajo mundet me thënë se nuk ka nevojë për me gjeneruar vende të reja të punës.

z. Agim Mani: Prioritet duhet me pasur kompania shtrirjen e saj në menaxhimin e mbeturinave.

z. Sabedin Vishi: Ndërmarrja “Pastërtia” i marrin me vonesë gjithmonë pagat, është mirë që po funksionon si njësi në veti, ndërkaq sa i përket menaxhimit, duhet monitorohet mirëmbajtja. Qëllimi është për me mirë, me rritur mirëqenien e punëtorëve aktual, me gjeneruar vende të reja të punës, mos me shpallë më tender për mirëmbajtje. Mirëmbajtja monitorohet se qysh bëhet, krejt kjo është duke u bërë për qëllimin me të mirë.

zpj. Kadrije Lika-Troni: Para së të jepet në menaxhim parkingjet ndërmarrjes “Pastërtia”, është mirë me pasur një plan të marrëveshjes, për një qytet me të bukur e më të pastër.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundesh me lidhë marrëveshje pa e ditur se a po ia jep në menaxhim apo jo parkingjet ndërmarrjes “Pastërtia”. As kryetari nuk mundet me lidhë marrëveshje, pa e pasur vendimin e KK, kushtet dhe kriteret përcaktohen me marrëveshje kur të lidhet bëhet publike, marrëveshja bëhet publike. Monitorimin e menaxhimit e bënë komuna. Unë nuk jam që mjetet e parkingut mos me u bashkua me të Ferizajt. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

APROVON

Propozim Vendimin për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendorit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

zpj. Kadrije Troni : Në këtë Propozim Vendim ka mjetet të ngelura edhe nga viti 2020. Cila është arsyaja që nuk është bërë bartja e këtyre mjeteve më herët ?

Kryesuesi i Kuvendit: Mund të ketë mjetet të ngelura që kanë mbetur pa shpenzuar nga të HVK dhe të njëjtat barten për shpenzim në vitin 2022. Mjetet e pa-alokuara a janë të 2 viteve?

z. Agim Mani: Të plani shihet së janë kalkuluar bartjet në total të mjeteve buxhetore. Pse mjetet e ngelura nga viti 2020 nuk janë bartur në vitin 2021 ? Nëse mjetet e ngelura nga viti 2020 do ishin bartur në vitin 2021, atëherë më nuk kemi punë më me mjetet e ngelura të vitit 2020.

z. Bahri Selimi: Mjetet e ngelura nga viti 2020 që nuk janë shpenzuar, duhet dihet prejardhja e tyre. Shumat e ngelura të mjeteve nga viti 2020 dhe ato të vitit 2021 bëhen bashkë si total përbartje në vitin 2022, se ka nga këto mjete që nuk janë alokuar. Shuma e mjeteve të bartura është 706.271.35€, nga këto mjete janë për investime kapitale 696.271€, tjerat janë për subvencione dhe transfere.

z. Sabedin Vishi: Duhet ditur burimin e tyre se nga kanë ardhur mjetet, sa janë nga viti 2020 dhe sa nga viti 2021, nëse financohet një projekt, duhet ditur burimin e mjeteve, sa mjete janë të vitit 2020 dhe sa mjete të vitit 2021.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, e

APROVON

Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Raporti periodik për zbatimin e rekondimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit;

Kryesuesi i Kuvendit, E hapi diskutimin për këtë pikë: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë raportin e shtroj në votim me ia kaluar KK në procedurë dhe i njëjtë u aprovua njëzëri, Në saje të kësaj konstatohet se KPF u njoftua me **Raportin periodik për zbatimin e rekondimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit** dhe i njëjtë i shkon Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.

7. Raporti i punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, E hapi diskutimin për këtë pikë: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë raportin e shtroj në votim me ia kaluar KK në procedurë dhe i njëjtë u aprovua njëzëri, Në saje të kësaj konstatohet se **KPF u njoftua me Raportin e punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut** dhe i njëjtë i shkon Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.

8. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë plani i punës së KKSB e shtroj në votim me ia kaluar KK në procedurë dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj konstatohet se KPF

APROVON

Planin e punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, për sqarime të nevojshme drejtori është prezent këtu, fjalën e ka drejtori i DUKMM Qamil Stagova.

z. Qamil Stagova: Kërkesa është paraqitur nga pronari, se iu ka prekë pak prona të shtëpia e tij të zyra e vendit në Ivajë. Komuna përfiton nga ky këmbim, sepse zgjerohet rruga dhe krijohet mundësia për trotuar. Sipërsaqja është 120 me 122që merr komuna.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika – Troni: A është duke funksionuar Zyra e Vendit në Ivajë?

z. Qamil Stagova: Për momentin Zyra e Vendit në Ivajë nuk është duke funksionuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Për ishin të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Propozim Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadri Lika-Troni: Kjo parcelë është në vendin ku është ndërtuar shkolla e re në Kovaçec. Me intereson të di, a janë ditur këto pika para se me u ndërtuar shkolla, se po preket prona private ?

z. Qamil Stagova: Me herët ka ekzistuar një marrëveshje kur ka qenë nënkyetar Remzi Elzei, komuna paska pasur marrëveshje me pronarët e pronave aty.

z. Agim Mani: Ne marrëveshje nuk kemi parë. Nëse kanë pasur marrëveshje gojore, ajo është diçka tjetër.

z. Qamil Stagova: Unë nuk e di, së nuk kam informata këtu, por është një punë e mirë që tani po rregullohet çështja e pronës së shkollës në Kovaçec.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse e shikojmë skicën, po supozoj së objekti i shkollës nuk ka pasur mundësi me u vendosur në këtë pozitë, pa parcelën e komunës. Me siguri se janë marrë vesh në atë kohë duke lejuar këtë parcelë në këmbim me atë komunale që është prapa shkollës.

z. Qamil Stagova: Pozita e shkollës ia ka imponuar me prekur në pronë private.

Kryesuesi i Kuvendit: Sigurisht pozita e shkollës ia ka imponuar me prekur në pronën private, për shkak së ka qenë hapësira e pamjaftueshme për realizim të projektit.

z. Agim Mani: Duhet pasur plan të DUKMM- së te çështja e ndërtimeve, se po na sjellin në një pozitë të keqe si anëtarë të KK me votu diçka që nuk është e ligjshme. Nëse ka pasur marrëveshje, është dashur ekzekutivi me na i sjellë marrëveshjen. Duhet ndryshohet kjo logjikë, se ka mundësi fillimisht me i marrë veprimet paraprake, pastaj me u realizuar projekt.

z. Qamil Stagova: Mua ashtu me është thënë, por marrëveshjen nuk e kam parë. Tani pritet që shkolla e Kovaçecit me u ndarë nga ajo e Bobit, për me funksionuar e pavarur.

z. Ramadush Osmani: Nganjëherë do procese duhet me u kryer paraprakisht, por investimi nuk të pret dhe ikë. Edhe këtu ka pasur mundësi me ikur donacioni.

z. Qamil Stagova: Pajtohem me vërejtjet, se fillimisht është dashur me u marrë veprimet paraprake, por kur është një punë e mirë e cila mundet me rregulluar tanë, duhet rregulluar e mos të mbetet gjithnjë pa rregulluar. Çështjet ndodhin së nganjëherë vendoset me u ndryshu projekti në ndërkokë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Çdo punë që bëhet, duhet të bëhet mirë duke përfillur procedurat. Është dashur fillimisht me u marrë veprimet paraprake para se me u realizuar projekti, me u lidhur marrëveshja me pronarin dhe ajo marrëveshje me u bërë publike.

Kryesuesi i Kuvendit: Ka raste edhe të paraluftës që kanë ngelur pa u rregulluar, ne po mundohemi tanë me e rregulluar gjendjen e tyre.

z. Ramadush Osmani: Gjendja është duke u sanuar në mënyrë ligjore. Është gjetur metoda e këmbimit që e lejon ligji. Ne jemi duke i sanuar devijimet e arsyeshme që janë bërë. Mund të jetë edhe imponim që shkolla e vjetër mos me u mbyllur deri me ndërtimin e objektit të ri.

z. Agim Mani: Nëse ka pasur marrëveshje, atëherë marrëveshja duhet të jetë publike. Organet e komunës duhet me funksionuar ne bazë të ligjit e jo në bazë të bisedave.

znj. Kadrije Lika-Troni: Agimi ka të drejtë, nëse ka pasur marrëveshje, atëherë paraprakisht duhet merren veprimet paraprake, pastaj me u realizuar projekti i shkollës. Inxhinierët e fushës është dashur me studiuar çështjen e hapësirë se a ka pasur hapësirë të mjaftueshme për shkollë. Kjo pjesë që është marrë, do të ishte mirë me u pas ndërtuar salla e dukatës fizike. Shkollën në f. Kovaçec e ka ndërtuar komuna dhe ajo shkollë nuk mund të themi së ka përfunduar.

z. Ramadush Osmani; Janë një mori faktorësh që kanë ndikuar me u marrë kjo pjesë, mund të jetë edhe imponim që shkolla e vjetër mos me u mbyllur deri me ndërtimin e objektit të ri dhe nuk i ka mjaftuar hapësira pa u prishur shkolla e vjetër.

z. Sabedin Vishi: Unë e kam vizituar shkollën në f. Kovaçec, gjendja e shkollës nuk është ashtu si flitet. Mund të themi lirisht se gjendje e shkollës është shumë më të mirë sesa do shkolla tjera të komunës, si ajo e Dubravës apo të ndonjë shkolle tjetër.

z. Agim Mani: Nëse një projekt në start nuk niset mirë, atëherë edhe përfundimi nuk del i mirë, si të çështja e shkollës në Kovaçec.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që kjo pikë t'i shkoj Kuvendit në procedurë? Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

APROVON

Propozim Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

11. Propozim Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i drejtorisë, Qamil Stagova, pastaj e hapi diskutimin:

z. Qamil Stagova: Arsyet e ndryshimit të trasesë rrugore është ne interes të komunës dhe kompanisë. Kërkesa është e kompanisë për ndryshimin e trasesë së rrugës në ZK Begracë. Janë dy parcela aty, toka shfrytëzohet për rrugë, nuk ka mëhallë aty, toka bëhet nga dy parcela në një parcelë, për shfrytëzimit me të mirë të kompanisë e cila e ka në shfrytëzim pronën komunale. Ajo pronë kur është dhënë në shfrytëzim, është ditur së shfrytëzuesi ka me i shfrytëzuar 2 parcelat.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A është në parametrat të pronës së dhënë me koncesion ajo pronë? Nëse nuk është në parametra, ne nuk kemi të drejtë me i ndërhyrë, se ne si KK kemi vendosur brenda përmasave të caktuara me dhënë në shfrytëzim pronën komunale, ai e ka në shfrytëzim atë pronë për 40 vite, se ajo pronë është e afatizuar. Nëse shfrytëzuesi i asaj prone, sa herë që bënë ndryshime të asaj prone, atëherë ne po duhet me u marrë me këto çështje.

z. Qamil Stagova: Prona është brenda parcelës që është dhënë në shfrytëzim, ndryshime bëhen vetëm këtë herë, e jo çdo herë, ndërkaq nevojë ka me u bërë këto ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit: Prona është brenda parcelës, vetëm nga pozita që është, lëshohet me poshtë rruga. Nëse është në interesin e investitorit dhe komunës me bërë një ndryshim, me marrëveshje, pse nuk kemi të drejtë ne me rregulluar këtë çështje.

z. Kadri Krivenjeva: Besoj se edhe për komunën edhe për kompaninë është më mirë që dy parcelat me u bërë një parcelë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Propozim Vendimin për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendorit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

12. Propozim Vendim për emërimin e anëtarëve te komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë ka pasur mundësi me shkuar drejt në KK, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Propozim Vendimin për emërimin e anëtarëve te komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Të njëjtën ia

REKOMANDON

Kuvendorit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:46. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF që ishin prezent. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 31 Mars 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murati

